



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:253173

Datë: 18.01.2021

Numri i dokumentit: 01416928

P.nr. 1006/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit I. R. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Pejë, PP/II.nr.2416/19 të datës 31.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 12.01.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit I. R., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.15.01.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

I. R. i lindur më në fsh., K. ..., ku edhe banon, me numër, i biri i Z. R. dhe nënës F. R., e gjinisë I., ka të kryer 8 klasë të shkollës fillore, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, bujk, me nr. tel, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Ne kohe të panjohur e deri me datën 27.01.2018 në fshatin – ..., përmes mënyrave tjera siguron shërbime për et cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që i pandehuri në shtëpinë e tij në adresën e lartcekur me një faze devijon energjinë jashtë matësit elektrik me shifërdhe energjia e shpenzuar përmes kësaj faze nuk regjistrohet fare, për çka kompaninëe dëmton në vlerë prej 151.31 euro.

- me çka ka kryer veprë penale, **vjedhja e shërbimeve**, nga neni 314 par. 1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, nenit 314 par. 1, të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

ME DENIM BURGIMI ME KUSHTË

- I.** Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar në qofte se i pandehuri ne afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.
- II.** I pandehuri lirohet nga pagimi i shpenzimeve procedurale për shkak se i njëjti jeton ne kushte te dobëta ekonomike.
- III.** E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2416/19 të datës 31.10.2019 kundër të pandehurit I. R. për shkak te veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 12.01.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe bazuar ne dispozitën e nenit 244 të KPP-së, është konstatuar prezenca e prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe te pandehurit I. R..

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se ka deklaruar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri ka pranuar fajësinë për veprat penale te cilat i vihen në barrë dhe ka deklaruar se i vie keq që ka ndodhur, ndihet i penduar dhe i premtion gjykatës se në të ardhmen nuk do ti përsërisë vepra te tilla.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit meqenëse te gjitha provat e

bashkangjitura aktakuzës, provojnë se i pandehuri i ka kryer të tri veprat penale për të cilat akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: procesverbali me numër 2312927, fatura mbi demin e shkaktuar DPE18HP11831 dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, si dhe shkresat tjera të lëndës, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit I. R. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe atë i ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Meqenëse i pandehuri jeton në kushte të vështira ekonomike i njëjti është liruar nga pagimi i shpenzimeve procedurale.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr. 1006/19 dt. 15.01.2021**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI,
Dr. Sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.